

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

DREJTUAR: DREJTORIT TE SHOQATES “AGJENSIA E ZHVILL.EKON.QENDRUESHEM – SEDA”

Opinion

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare te shoqerise “AGJENSIA E ZHVILL.EKON.QENDRUESHEM – SEDA., me Nipt K22419001Q, qe jane bashkelidhur ketij raporti, te cilat perfshijne: pasqyren e Pozicionit Financiar me date 31.12.2020, pasqyren e te ardhurave gjithepershires, pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e flukseve te parase per vitin qe mbyllet ne kete date, si edhe shenimet per pasqyrat financiare, perfshire nje permbledhje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkelidhur, paraqesin drejt, ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te shoqerise “AGJENSIA E ZHVILL.EKON.QENDRUESHEM – SEDA me date 31/12/2020 dhe performancen financiare dhe flukset e parase per vitin qe mbyllet ne kete date, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Raportimit Financiar (SKK) dhe parimet e pergjithshme te pranuar per to.

Baza per Opinionin

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit (SNA-te). Pergjegjesite tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar ne menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Pasqyrat Financiare. Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me Kodin e Etikes per Profesionistet Kontabel te Bordit Nderkombetar per Standardet e Etikes (Kodi i IESBA) dhe Kodit te Institutit te Audituesve Ligjore (Kodi i IEKA), se bashku me kerkesat etike te Ligjit Nr. 10091, date 5 mars 2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilitetit te miratuar” te amenduar, qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi, dhe kemi permbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me keto kerkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tone.

Ceshtjet Kryesore te Auditimit

Ceshtjet kryesore te Auditimit jane ato ceshtje qe, nen gjykimin tone profesional, ishin me te rendesishmet gjate auditimit te pasqyrave financiare te periudhes aktuale. Keto ceshtje jane adresuar ne kontekstin e auditimit te pasqyrave financiare ne teresi, dhe gjate formimit te opinionit tone, per rrjedhoje, dhe ne nuk paraqesim nje opinion te vecante per keto ceshtje.

Pergjegjesite e Drejtimit dhe te Personave te Ngarkuar me Qeverisjen ne lidhje me pasqyrat financiare.

Drejtimi i Shoqerise Tuaj, eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre Pasqyrave Financiare, te cilat jane pergatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Raportimit Financiar(SKK), dhe per ato kontrole te brendshme qe drejtimi i gjykon te nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit apo gabimit.

Ne pergatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi eshte pergjegjes per te vleresuar aftesine e Shoqerise per te vazhduar ne vijimesi, duke dhene informacion, nese eshte e zbatueshme, per ceshtjet qe kane te bejne me vijimesine dhe duke perdorur

parimin kontabel te vijimesise pervec se ne rastin kur drejtimi synon ta likujdoje shoqerine ose te nderprese aktivitetet, ose nese nuk ka alternative tjeter reale pervec sa me siper.

Ata qe jane te ngarkuar me qeverisjen jane pergjegjes per mbikqyrjen e procesit te raportimit financiar te shoqerise.

Pergjegjesite e Audituesit per Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona jane qe te arrijme nje siguri te arsyeshme lidhur me faktin nese pasqyrat financiare ne teresi nuk kane anomali materiale, per shkak te mashtrimit apo gabimit, dhe te leshojme nje raport auditimi qe perfshin opinionin tone. Siguria e arsyeshme eshte nje siguri e nivelit te larte, por nuk eshte nje garanci qe nje auditim i kryer sipas SNA-ve do te identifikojte gjithmone nje anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalite mund te vijne si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nese, individualisht ose te marra se bashku, pritet qe ne menyre te arsyeshme te influencojne vendimet ekonomike te perdoruesve, te marra bazuar ne keto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit ne perputhje me SNA ne ushtrojme gjykimin dhe skepticismin tone profesional gjate gjithë periudhes se auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojme dhe vleresojme rrezikun e anomalive materiale ne pasqyrat financiare, si pasoje e mashtrimit apo gabimeve, planifikojme dhe zbatojme procedurat perkatese per zbutjen e ketyre rreziqeve, si dhe marrim evidence te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te krijuar nje baze per opinionin tone. Rreziku i moszbulimit te nje anomalie si pasoje e mashtrimit eshte me i larte se rreziku i moszbulimit te nje anomalie si pasoje e gabimit, per shkak se, mashtrimi mund te perfshije fshehje te informacionit, falsifikim te informacionit, pervesitime te qellimshme, keqinterpretime, apo shkelje te kontrollit te brendshem.

- Marrim nje kuptuesmeri te atyre kontrolleve te brendshme, relevante per procesin e auditimit me qellim hartimin e procedurave te auditimit ne perputhje me rrethanat, por jo per te shprehur nje opinion mbi efektivitetin e kontrolleve te brendshme.

- Vleresojme pershtatshmerine e politikave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te kryera si edhe paraqitjen ne shenimet shpjeguese perkatese te bera nga drejtimi

- Shprehemi ne lidhje me pershtatshmerine e parimit te vijimesise, bazuar ne evidencat e marra gjate auditimit, mbi ekzistencen e nje pasigurie materiale mbi aftesine e shoqerise per te vazhduar ne vijimesi aktivitetin e saj. Nese nje pasiguri materiale ekziston ne duhet te terheqim vemendjen ne shenimin shpjegues perkates, nepermjet raportit tone te auditimit, ose nese shenimet shpjeguese nuk jane te pershtatshme, ne duhet te modifikojme opinionin tone. Perfundimet tona jepen mbi bazen e evidences se auditimit te marre deri ne daten e raportit te auditimit. Megjithate, ngjarjet ose kushtet ne te ardhmen mund te shkaktojne nderprerje te aftesis se shoqerise per vijimesi.

- Vleresojme paraqitjen, strukturen dhe permbajtjen e pasqyrave financiare dhe te shenimeve shpjeguese dhe ne rast se ato perfaqesojne drejt transakcionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojme me personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqerise, pervec ceshtjeve te tjera, edhe objektin dhe kohen e planifikuar te auditimit, gjetjet kryesore te auditimit, perfshire cdo mangesi relevante ne kontrollin e brendshem te identifikuar gjate auditimit tone.

Ne angazhimin tone per auditimin e Pasqyrave Financiare te "AGJENSIA E ZHVILL.EKON.QENDRUESHEM – SEDA nuk ka kerkesa te tjera nga ana e Drejtitimit per tu raportuar nga ne.

Tirane, me 25.03.2021

AUDITUESI LIGJOR

Armando FEHLAHAJ

